



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 778/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, Ramadan Parduzi, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, paraqitur kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.778/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, Ramadan Parduzi, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në Qendrat e Votimit nr. 2701B, 270613B, 2715, 2704B, 2722B, 2727B.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.778/2021, nga Ramadan Parduzi, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, në të cilën pretendon se ka qenë kandidat për asamble komunale në Vushtrri në radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me nr.25 dhe pas mbledhjes së informacioneve në qendrat të shënuara në apel nuk iu kanë regjistruar votat. Parashtruesi i apelit thekson se këto dilema janë vërtetuar edhe kur janë numëruar 11 kutitë kutitë e votimit në Komunën e Vushtrrisë ju kanë shtuar 11 vota. Kërkon nga PZAP-i të bëhet hapja e kutive në këto qendra, Shkolla "Bahri Haxha Vushtrri" me nr.2701B, 14 kutia të votimit, Shkolla "Abdyl Frashëri Druar" me nr. 270613B, 2 kutia të votimit, Shkolla 21Gojbulë me nr. 2715, 1 kuti të votimit, Shkolla filllore Studime e Epërme 2718B, 1 kuti e votimit, Shkolla filllore Mustafë Venhari Vushtrri 2704B, 1 Kutie e votimit, Shkolla filllore Pestovë, 2722B, 2 kutia të votimit, Shkolla filllore Shtitaricë 2727B, 2 kutia të votimit.

Parashtruesi i apelit thekson se apelit i ka bashkangjitur formularin e PZAP-së me të dhënat e tij, dëshmitë e votuesve, ndërhyrjet në kopjet e FPR-ve në Qendrat e Votimit etj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

### **Apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtuesi i apelit kërkon që të rinumërohen kutitë në Qendrat Votuese në Komunën e Vushtrrisë. Mirëpo, pretendimet në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në cilat vendvotime janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, por vetëm i potencon disa emra të disa shkollave me të cilën gjatë numrimit iu janë shtuar 11 vota , duke mos treguar se sa vota mendon se i mungojnë, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtuar e konsideron si të përgjithshëm dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara ngase parashtuesi i apelit nuk ka specifikuar asnjë vendvotim, pasi që vendvotimet në të cilat zhvillohet votimi janë të përcaktuara me numra përkatës, e për të cilën pala ankuese nuk i ka potencuar edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtuesin e apelit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.778/21 më datë 05.11.2021

**Kryesues i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.